

TEORI E PËRKTHIMIT

Syllabusi 2013/2014

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Filologjisë/ Departamenti i Gjuhës Shqipe

Niveli dhe lloji i kursit: (Bachelor/Zgjedhore)

Viti i studimeve dhe semestri: Viti III- Semestri V

Numri i orëve në javë: 1+1

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 4

Mësimdhënësi i kursit:

Prof. asc. dr. Shkumbin Munishi

Detajet kontaktuese:

Zyra 60

Tel: 044 124 290

Email: shmunishi@hotmail.com

Qëllimi i lëndës:

Objektivi i kësaj lënde është që t'u ndihmojë studentëve të mësojnë anën teorike të përkthimit dhe t'i njohin teknikat e përkthimit, pa marrë parasysh se cilat gjuhë të huaja i flasin ata.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pasi ta ketë përfunduar me sukses modulin, studenti do të jetë në gjendje:

- të fitojë njohuri themelore mbi teorinë dhe teknikat e përkthimit
- të fitojë njohuri themelore për procesin e komunikimit njerëzor në përgjithësi
- ta kuptojë rolin dhe rëndësinë e përkthimeve si formë e komunikimit.

Metodologjia e mësimdhënies:

Ligjëratë, diskutime dhe ushtrime praktike seminare/ese.

Literatura bazë:

Mirela Kumbaro. Interpretimi: ta ushtrojmë, ta mësojmë. Rrokullia. Prishtinë, 2013.
Dr. Shykrane Gërmizaj. Translation Theory in the Classroom. Prishtinë, 2005.

Plani i detajuar i mësimi:

Java e parë: Hyrje në problemet e teorisë së përkthimit (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 11-15)

Java e dytë: Historia e përkthimit (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 15-21)

Java e tretë: Definicionet e përkthimit (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 21-22)

Java e katërt: Definicioni lingvistik dhe filologjik i përkthimit (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 22-23)

Java e pestë: Definicioni komunikativ i përkthimit (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 23-25)

Java e gjashtë: Funkcionet shoqërore të përkthimit (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 69-75)

Vlerësimi i parë intermediar

Java e shtatë: Natyra e përkthimit: çka është përkthimi, përkthimi si formë e komunikimit; informata dhe mesazhi; kanali komunikues, dërguesi dhe pranuesi. (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 27-35)

Java e tetë: Format, llojet dhe tipat e përkthimit: përkthimi i teksteve dhe përkthimi i të folurit ose interpretimi (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 37-44)

Java e nëntë: Format e përkthimit me gojë: përkthimi simuluan dhe konsektiv (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 44-46)

Java e dhjetë: Përkthimi letrar dhe joletrar; përfitimet dhe humbjet gjatë përkthimit; akomodimi (përshtatja) i përkthimit (49-54)

Java e njëmbëdhjetë: Përkthimi me makinë dhe përkthimi me ndihmën e kompjuterit (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 54-69)

Vlerësimi i dytë intermediar

Java e dymbëdhjetë: Procesi dhe prodhimi i përkthimit (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 77-89)

Java e trembëdhjetë: Analiza kontrastive e përkthimeve (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 89-125)

Java e katërbëdhjetë: Mjetet për përkthim (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 125-130)

Java e pesëmbëdhjetë: Diskutim mbi problemet e sotme në fushën e përkthimeve të shqipes; shembuj të problemeve në përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe (Literatura: Gërmizaj, 2005, fq. 133 -235)

Vlerësimi përfundimtar

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi gjysmësemestral: 35%

Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 10%

Vijimi i rregullt: 5%

Provimi final: 50%

Totali: 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet t'i ndjekin me rregull ligjëratat. Në rast të mungesave të shumta të paarsyeshme studentëve nuk do t'u verifikohet pjesëmarrja e rregullt në ligjëratat e ushtrime. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

Studentët do të orientohen që të kërkojnë literaturën tjetër në biblioteka dhe nëpërmjet Internetit. Mësimdhënësi do t'i ndihmojë studentët që të bëjnë kërkime personale të literaturës dhe kjo do të bëhet edhe gjatë orarit të konsultimeve.